

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 6 TETOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kërkesa, që paraqesin 15 deputetë të Partisë së Lirisë dhe të Partisë Demokratike, ka lidhje me një funksion thelbësor, për të cilin parlamenti ekziston dhe, jashtë të cilit, ky parlament nuk do të kishte më kuptim të vazhdonte të qëndronte. Ka të bëjë pikërisht me llogaridhënien dhe, aq më shumë, për një institucion të cilin e zgjedhim ne. Të gjithë anëtarët e ERE-s i zgjedh Kuvendi. Është një institucion që i ka të gjitha atributet që të monitorojë, të vendosë për elementet kyçe që kanë të bëjnë me energjinë elektrike, ndaj thirrja e tij, bazuar në nenin 103, pikat 8 dhe 9, është gjëja më e natyrshme dhe më e pakta që mund të bënte Kuvendi i Shqipërinë në një moment që cilësohet nga më strategjikët, siç është energjia eklektike. Është jetike për ta thirrur, sepse qytetarët duan të dinë qartë se ç'bëhet me energjinë elektrike.

Qytetarët kanë parë që energjia është përdorur si një plaçkë elektorale, plaçkë propagandistike, plaçkë për të shpërblyer patronazhistët, por asnjëherë si një e mirë e madhe publike që duhet t'u shërbejë qytetarëve. Faktet janë të rënda dhe kokëforta. Është fakt që shpenzohen 1 miliard euro për humbje teknike dhe kemi, as më shumë dhe as më pak, 1% ulje të tyre, ndërkohë që nuk u është kursyer burgu qytetarëve, qoftë edhe për borxhe të vogla. Dështimet në të gjitha pikëpamjet janë të jashtëzakonshme. Kemi parë edhe vendosjen e fashës së energjisë elektrike, që u trajtua si mall propagande, sepse, pasi u vendos, vijuan deklaratat për pezullimin nga Kryeministri, ndërkohë që të gjithë e dinë shumë mirë se organi që vendos çmimin është ERE-ja. Vendimet e saj janë të detyrueshme për zbatim dhe nuk janë atribut as i Kryeministrit, as i askujt tjetër, prandaj ky rezultoi thjesht e vetëm një mashtrim.

Ligji për energjinë flet qartë për këtë, ndaj sqarimet deri në një për këtë çështje janë të domosdoshme, të paevitueshme dhe çdo qëndrim tjetër do të thoshte të minohej, të hidhej në

erë funksioni bazik i parlamentit, që është llogaridhënia, aq më tepër për institucione që po i ngre vetë. Çdo shmangie nga ky detyrim, nga kjo çështje, largim apo ikje do të thotë fshehje e korrupsionit galopant dhe të frikshëm në sektorin e energjisë dhe fshehja përpara qytetarëve se si ata grabiten përditë për interesa thjesht e vetëm korruptive. Faleminderit!